



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO		
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo		
Ministria e Financave / Ministarstvo za Financije		
Ministry of Finance		
Arkiva - Arhiva - Archive		
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit:	01	Nr. Prot. Pr. Prot. Prot. No.: 293
Nr. ifaqëve Proj. stranica No. pages:	1	Data Datum Date: 18.03.2020

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave dhe Transfereve

Ministarstvo za Financije i Transfere / Ministry of Finance and Transfers

Nr. 25/2020

Datë: 18.03.2020

Në mbështetje të nenit 8, paragrafi 1.4, të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, me qëllim të zbatimit të Vendimit Nr. 01/07 dhe 01/09 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për marrjen e masave shpesh pas konfirmimit të rasteve pozitive me Corona Virus COVID 19, Ministri i Financave dhe Transfereve merr këtë:

VENDIM

1. Shtyhet deri në 30 qershor 2020 afati për dorëzimin e deklaratave në KKRF për pasivitet të vitit paraprak afarist për shoqëritë tregtare, të cilat gjatë vitit afarist nuk ka pasur aktivitet afarist dhe nuk ka regjistruar asnjë të dhënë mbi pasuritë dhe detyrimet në librat kontabël, sipas nenit 18, paragrafi 4, i Ligjit Nr. 06/L- 032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.
2. Shtyhet deri në 30 qershor 2020 dorëzimi në KKRF për publikim i pasqyrave vjetore financiare përkatësisht pasqyrat vjetore financiare të konsoliduara, raportin e menaxhmentit, raportin e konsoliduar të menaxhmentit dhe raportin e auditimit të pasqyrave vjetore financiare, përkatësisht raportin e auditimit të pasqyrave vjetore financiare të konsoliduara, nga shoqëritë tregtare, sipas nenit 18, paragrafi 1, i Ligjit Nr. 06/L- 032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.
3. Shtyhet deri në 30 qershor 2020 dorëzimi në KKRF i pasqyrave vjetore financiare, respektivisht pasqyrave financiare të konsoliduara dhe raportin e rishikimit të pasqyrave vjetore financiare të konsoliduara nga shoqëritë tregtare, sipas nenit 18, paragrafi 2, i Ligjit Nr. 06/L- 032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.
4. Shtyhet deri në 30 qershor 2020 afati për dorëzimin e pasqyrave financiare të audituara në pajtim me SNA-të në KKRF dhe publikimi i tyre, si dhe dorëzimi i tyre në ministrinë përkatëse për tregti dhe industri, sipas nenit 17, paragrafi 1, i Ligjit Nr. 06/L- 032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.
5. Shtyhet deri në 30 qershor 2020 afati për dorëzimin në Agjencinë e Statistikave të Kosovës dhe në KKRF e pasqyrave për pozitën financiare, llogaritë e fitimit dhe humbjeve si dhe informatat shpesh lidhur me vitin paraardhës kalendarik për qëllime statistikore dhe qëllime të tjera, sipas nenit në përputhje me nenin 19, paragrafi 1, i Ligjit Nr. 06/L- 032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

6. Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit



Besnik Bislimi

**Ministër i Financave dhe
Transfereve**

Vendimi i dërgohet:

- KKRF-së; dhe
- Arkivit të Ministrisë;